

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA E ADMINISTRATËS

Mr./aq/Br./str. 172
Datë/Date: 29.09.2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 29.09.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.09.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 887, të datës 01.09.2023, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 61, paragrafi 61.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë Nr. 03/L-048, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024, në shumë të përgjithshme prej 16,285,500.00€, i shpërndarë nëpër programe e nën-programe të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 964 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 7,929,594.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 2,160,325.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 350,000.00€;
 - 1.4 Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,124,607.00€;
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,720,974.00€.
2. Vlerësimet e hershme të caktuara me kufijtë për Buxhetin e Planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2025, është në shumë të përgjithshme prej: 17,098,097.00€ dhe për vitin fiskal 2026, është në shumë të përgjithshme prej: 17,938,765.00€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, mbështetur në tabelat buxhetore për Buxhetin e vitit 2024 për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve, të planifikuara dhe të përshkruar në paragrafin një dhe dy të këtij vendimi dhe zbatim i tij, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili